



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.132/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Skënder Çoçaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare Udruženje Žena Povratnica “Naš Dom”, të parashtruar ndaj vendimit të KQZ-së, me nr. Protokolli 01/2682-2025, të datës 06.10.2025, për Refuzimin e akreditimit të vëzhguesve zgjedhor, në lidhje me aplikimin për akreditim të vëzhguesve zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2025, mori këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.132/2025, e datës 08.10.2025, e parashtruar nga Organizata Joqeveritare Udruženje Žena Povratnica “Naš Dom”, mbetet në fuqi vendimi i KQZ-së me nr. 01/2682-2025, të datës 06.10.2025, për Refuzimin e akreditimit të vëzhguesve zgjedhor, në lidhje me aplikimin për akreditim të vëzhguesve zgjedhor për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

Arsyetim

Më datë 08.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare Udruženje Žena Povratnica “Naš Dom”, në të cilën pretendohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka refuzuar akreditimin e 52 (pesëdhjetë e dy) vëzhguesve zgjedhor, për përcjelljen e ditës së zgjedhjeve në zgjedhjet lokale që do të mbahen më datë 12 tetor 2025.

Më tej në ankesë theksohet se KQZ e ka bazuar pjesërisht vendimin, në faktin se mes vëzhguesve të paraqitur ishin 49 burra dhe 3 gra. Mirëpo rregullorja për akreditim e vëzhguesve nuk e përcakton kriterin gjinor si kusht për akreditim. Tutje në ankesë theksohet se KQZ- ja pohon se disa prej vëzhguesve janë punësuar më parë si vëzhgues të subjekteve politike, por që tani ata nuk janë më të angazhuar politikisht, e që janë të gatshëm të nënshkruajnë deklarata për neutralitet politik dhe nuk marrin ndonjë kompensim financiar.

Tutje, në ankesë theksohet se OJQ “Naš Dom” merr pjesë aktive në projekte me interes publik, duke përfshirë punën me persona të moshuar dhe të rrezikuar, promovimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen përfshirëse në proceset sociale, duke kërkuar kështu nga PZAP-i që ta pranojë ankesën si të bazuar, ta anuloj vendimin e KQZ-së me numër 01/2682-2025, të datës 06.10.2025, si dhe ta urdhëroj KQZ-në që të akreditoj 52 vëzhgues të “Naš Dom”.

Në përgjigje në kërkesë KQZ ka theksuar se pas verifikimit të bërë kanë konstatuar se sipas statutit të organizatës Udruženje Žena Povratnica “Naš Dom”, kjo organizatë është themeluar me qëllim që ta sigurojë pavarësinë ekonomike për gratë, përparimin e barazisë gjinore. Tutje shtohet se organizata ka aplikuar me gjithsej 52 vëzhgues, ku nga 52 gjithsej 49 ishin burra, shprehur në përqindje 94.23%, e që përkatësia gjinore e vëzhguesve nuk përkon me qëllimin e themelimit, pra bie ndesh me qëllimin e organizatës. Në përgjigje në ankesë theksohet se prej 52 vëzhguesve me të cilët organizata ka aplikuar për akreditim, sipas verifikimit me bazën e të dhënave të vëzhguesve dhe trupave menaxhues zgjedhor për Zgjedhjet në Kuvendin e Kosovës të datës 9 shkurt 2025, rezulton se vëzhguesit kanë qenë të angazhuar si vëzhgues të subjekteve politike dhe trupa menaxhues zgjedhor, që bie ndesh me kërkesën ligjore që del nga neni 57 i LPZ-së për paanshmërinë dhe neutralitetin e vëzhguesve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa- PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se :

- **Ankesa është e pabazuar.**

- Pretendimet e palës ankuese se KQZ me vendimin me numër 01/2682-2025, të datës 06.10.2025, Refuzimin e akreditimit të vëzhguesve zgjedhor për Zgjedhjet Lokale 2025, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LZP-së Nr. 08/L-228, Paneli i vlerësoj si të pabazuara për faktin se me dispozita ligjore përcaktohet qartë akreditimi i vëzhguesve, ku shprehimisht dispozita e nenit 54 paragrafi I i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr.08/L-228, parasheh se *“Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të, organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim për vëzhgues të zgjedhjeve”*.

Paneli pas verifikimit të provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe përgjigjes së KQZ-së, vërtetoi se OJQ-së “Naš Dom”, sipas vendimit nr.01/2682-2025, të datës 06.10.2025, Refuzimin e akreditimit të vëzhguesve zgjedhor për Zgjedhjet Lokale 2025, i është refuzuar akreditimi për shkak se qëllimi i paraqitur në statut të organizatës nuk përkon me procesin zgjedhor, që do të thotë se KQZ, ka vepruar konform dispozitave ligjore.

Paneli, mori veprime hetimore konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, në të cilin nen thuhet se *“Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme”*. Andaj Paneli pas hetimit dhe verifikimit lidhur me pretendimet e parashtresit të ankesës ka gjetur

se ankesa është e pabazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi i të dhënave në sistemin elektronik të OJQ-ve, ka gjetur se organizata joqeveritare Udruženje Žena Povratnica “Naš Dom”, në statutin e tyre kanë të caktuar fushëveprimin e tyre i cili është: Barazi gjinore, përkrahje biznesi, ndihmë sociale dhe psikologjike, pra që në statut të qëllimit të tyre nuk është i përcaktuar procesi zgjedhor ose ndonjë veprimtari që ka lidhje zgjedhjet.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 54, paragrafi 2, neni 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.132/2025 më datën 10.10.2025



KËSHILLAJURIDIKE: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*